



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 23 Prill 2021

Nr. 279

**VENDIM**

**Objekt:** Për shqyrtimin administrativ të kërkesës së Partisë Demokratike të Shqipërisë për marrjen e masave të menjëhershme për anulimin e urdhit nr. 219 datë 19.04.2021, të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, “Për karantinimin e personave që vijnë në Republikën e Shqipërisë nga Republika e Maqedonisë së Veriut dhe Greqia”

**Kërkues:** Partia Demokratike e Shqipërisë

**Ndaj:** Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

**Baza Ligjore:** Neni 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, neneve 23 dhe 24 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga administrata gjatë procesit të hetimit administrativ,

**VËREN:**

Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në datën 20.04.2021, është depozituar nga Partia Demokratike e Shqipërisë, një kërkesë për marrje masash të menjëhershme, për shkak se më datë 19 prill 2021, Komiteti Teknik i Ekspertëve pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes



Sociale, ka vendosur që për dy javët e ardhshme, personat që vijnë nga Maqedonia e Veriut dhe Greqia, do ti nënshtrohen karantinës për shkak të situatës së pandemisë.

Mbi të njëjtën problematikë, me shkresën nr. 1413/2 prot., datë 22.04.2021, administruar me tonën me nr. 4278 prot., datë 22.04.2021, me lëndë mbi anulimin e urdhrit nr. 219, datë 19.04.2021, të Ministrisë të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për heqjen e çdo pengese ndaj shtetasve shqiptarë që kthehen në atdhe nga Republika e Greqisë dhe Republika e Maqedonisë së Veriut, për të votuar më datë 25 prill 2021 dhe përmbushjen e rekomandimeve të Avokatit të Popullit, Presidenti i Republikës së Shqipërisë i drejtohet Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Avokati i Popullit me shkresën nr. 222 prot., datë 21.04.2021, administruar me tonën me shkresën nr. 4216 prot., datë 22.04.2021, bën me dije Komisionin Qendror të Zgjedhjeve mbi rekomandimin për anulimin tërësisht e menjëherë të urdhrit nr. 219 datë 19.04.2021 “Për karantinimin e personave që vijnë në Republikën e Shqipërisë nga Republika e Maqedonisë së Veriut dhe Greqia”.

Nenit 65 “Verifikimi paraprak përpara fillimit të procedurës administrative” i Kodit të Procedurës Administrative të Republikës së Shqipërisë” parashikon se:

Në fillim të procedurës administrative, organi publik kryen verifikimet e mëposhtme:

- a) nëse të drejtat apo interesat e kërkuara nga palët janë subjekt i ndonjë kufizimi kohor;
- b) legjitimitimin e palës që ka paraqitur kërkesën për fillimin e procedurës administrative;
- c) nëse afati i përcaktuar me ligj për dorëzimin e kërkesës është respektuar;
- ç) nëse kërkesa e një pale për fillimin e një procedure administrative mund të shqyrtohen së bashku me kërkesat e palëve të tjera, nëse bazohet në të njëjtat fakte dhe bazë ligjore.

Meqenëse në KQZ janë paraqitur tre kërkesa, nga PD, Avokati i Popullit dhe Presidenti i Republikës që trajtojnë të njëjtën çështje, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vendos në mbështetje të nenit 65 shkronja “ç” të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, shqyrtimin së bashku të kërkesave të subjektit politik PD dhe kërkesën e Presidentit të Republikës.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 23.04.2021, çmon të vlerësojë ligjshmërinë, për shqyrtimin e objektit të kërkesës së Partisë Demokratike të Shqipërisë ndaj Komitetit Teknik të Ekspertëve, në prani të përfaqësuesve ligjorë të subjekteve zgjedhore Partia Socialiste e Shqipërisë,

Partia Demokratike e Shqipërisë, Partia Lëvizja Socialiste për Integrim, Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet, Partia Social Demokrat e Shqipërisë.

Sipas përcaktimeve të nenit 23, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, *“Me fillimin e procedurës administrative, organi publik verifikon nëse ka apo jo kompetencë lëndore dhe tokësore për të vendosur për çështjen objekt shqyrtimi”*, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve shqyrtoi paraprakisht kërkesën lidhur me kompetencën e organit publik për shqyrtimin e saj.

Juridiksioni dhe kompetenca janë parakushte procedurale që duhet të plotësohen në mënyrë që të krijohet një marrëdhënie juridike procedurale e vlefshme.

Subjekti Zgjedhor Partia Demokratike ka paraqitur një kërkesë për marrje masash të menjëhershme, për shkak se më datë 19 prill 2021, Komiteti Teknik i Ekspertëve pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ka vendosur që për dy javët e ardhshme, personat që vijnë nga Maqedonia e Veriut dhe Greqia, do të nënshtrohen karantinës për shkak të situatës së pandemisë.

Pika 3, e nenit 7, të ligjit nr. 15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, parashikon se, *“Për të mbrojtur popullatën nga sëmundjet infektive, që kanë impakt të madh në shëndetin e saj, si kolera, murtaja, ethet e verdha, ethet hemorragjikevirale, SARS, gripi pandemik dhe sëmundje të tjera që mund të shfaqen, ministri përgjegjës për shëndetësinë, në përputhje me Rregulloren Ndërkombëtare të Shëndetit, miraton, me urdhër; masa të veçanta për mbrojtje nga këto sëmundje”*:

- a) kufizimin ose ndalimin e udhëtimeve në vendin ku është përhapur epidemia nga këto sëmundje;
- b) kufizimin ose ndalimin e qarkullimit në rajonet e infektuara ose të rrezikuara;
- c) kufizimin ose ndalimin e qarkullimit të llojeve të ndryshme të mallrave dhe produkteve;
- d) marrjen pjesë, në mënyrë të detyrueshme, të institucioneve shëndetësore dhe institucioneve të tjera, si dhe të qytetarëve në luftimin e sëmundjes ngjitëse, shfrytëzimin e objekteve dhe mjeteve të transportit.

Në mbështetje të dispozitës së sipërcituar, është miratuar urdhri nr. 219, datë 19.04.2021, i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, “Për karantinimin e personave që vijnë në Republikën e Shqipërisë nga Republika e Maqedonisë së Veriut dhe Greqia”. Pra, në rastin konkret urdhri nr. 219, datë 19.04.2021 “Për karantinimin e personave që vijnë nga në Republikën e Shqipërisë nga republika e Maqedonisë së Veriut dhe Greqia” i ministres së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka dalë në bazë



dhe për zbatim të nenit 7 të ligjit nr. 15/2016 “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive” dhe është kompetencë e ministrit të shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale.

Për sa më sipër, referuar neni 24, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, *“Kur një organ publik merr një kërkesë, për një çështje që e vlerëson jashtë kompetencës të vet, ia përcjell kërkesën menjëherë, dhe në çdo rast jo më vonë se dy ditë nga marrja e saj, organit publik kompetent dhe njofton kërkuesin për këtë.*, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerëson se kërkesa është jashtë kompetencës së tij lëndore dhe nuk mund të vazhdojë shqyrtimin administrative, për kërkesën e depozituar nga Partia Demokratike e Shqipërisë.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f ” dhe “n”, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, neneve 23 dhe 24 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”,

### **V E N D O S:**

1. Të shpallë moskompetencën lëndore të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për shqyrtimin e kërkesës.
2. Të përcjellë menjëherë kërkesën për kompetencë, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si organ publik, kompetent për ta shqyrtuar këtë kërkesë.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**

